



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:173001
Datë: 25.06.2024
Numri i dokumentit: 05854397

Ac.nr.811/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË- në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarët Fatmir Baloku - kryetar i kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Dardan Kadolli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses M.L-B nga fsh.A..., Komuna Glllogoc, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av.A.K nga Prishtina, kundër te paditurës B.K.S rruga ‘’....’’, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim M.P, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 14.364 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.194/16, të datës 28.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 19.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës B.K.S, me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.194/16, të datës 28.12.2020, ashtu që NDRYSHOHET aktgjykimi në pikën b) të dispozitivit, në pjesën që ka të bëjë me rehabilitimin fizio terapeutik-klimatik, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M.L-B nga fsh.A... Komuna Glllogoc, sa i përket rehabilitimit fizio terapeutik-klimatik në shumë prej 300 euro, ndërsa në pikat tjera Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.194/16 i datës 28.12.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.194/16, të datës 28.12.2020, ka vendosur si vijon: I.PJESERISHT MIRATOHET kërkesëpadia e paditëses M.L-B nga fsh.A... Komuna Glllogoc SI E BAZUAR, dhe DETYROHET e paditura B.K.S rruga ‘’....’’, në Prishtinë që paditëses në emër të dëmit jomaterial dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me dt.07.12.2015 rrethe orës 07;30 min në rrugën Komoran –Drenas në fsh...., Komuna Glllogoc të kompensojnë;

A)Demin jo material:

Ne emër të dhimbjeve trupore fizike shumen prej 4.500 euro,

Ne emër të frikës së përjetuar shumen prej 1.500 euro,

Ne emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor në shkallën prej 5 % shumen prej 1.500 euro

B) Demin material:

Ne emër të ndihmës së personit tjetër shumen prej 420 euro

Ne emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 140 euro

Ne emër të rehabilitimit fizio terapeutik-klimatik Shumen prej 300 euro

Ne emër të shpenzimeve të mjekimit shumen prej 240 euro.

II.DETYROHET e paditura shumat e gjykuara (aprovuara) si ne par. I-te dispozitivit të ja paguaj paditësës me kamate 12% të interesit vjetor duke filluar nga dt.05.01.2016 kur paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar kërkesë për dëmshpërblim tek e paditura e gjere të pagesa definitive si dhe DETYROHEN që ne emër të shpenzimeve të procedurës të i paguaj paditësit shumen prej 1.409 euro të gjitha këto detyrime në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbartimit ligjor. -Pjesa tjetër e kërkesës së paditësit për shpenzimet e procedurës në shumen prej 551 euro refuzohet e pa bazuar. III. REFUZOHET E PA BAZE kërkesëpadia e paditësës me e larte se sa shuma e gjykuar (aprovuar)si në par.I.A) të dispozitivit që ka të bej me kompensimin e demit jo material dhe atë; për dhimbje fizike 2.500 euro, për frike 1.000 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 1.000 euro si dhe kërkesëpadia se paditësës me e larte se sa shuma e gjykuar(aprovuar) si në par.I.B) të dispozitivit që ka të beje me kompensimin e demit material dhe atë; në emër të ndihmës së personit tjetër 480 euro dhe në emër të ushqimit të përforcuar 660 euro.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin ta ndryshojë dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar apo që aktgjykimi të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Paditësja përmes të autorizuarës së saj ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datën 25.08.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës për shkak të kompensimit të demit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë dhe pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.194/16, të datës 28.12.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësës duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm sa i përket pjesës së vërtetuar, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gabimisht është vërtetuar gjendja faktike kur është gjykuar për kërkesëpadinë në emër të rehabilitimit fizio-terapeutik klimatik dhe në këtë pjesë e drejta materiale është zbatuar gabimisht, për çka u deshtë që aktgjykimi i atakuar në fjalë të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e shkallës së parë në pjesën vërtetuese i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit që nuk është kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizave të ekspertëve mjekësorë i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në pjesën e vërtetuar nga Gjykata e Apelit, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material në pjesën e vërtetuar nga Gjykata e Apelit gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes ekspertizave mjekësore të ekspertëve mjekësor nga lëmia e ortopedisë, neurokirurgjisë dhe psikiatrisë për të cilat ekspertiza ka dhënë shpjegimet e saj në arsyetim të aktgjykimit, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar në tërësi vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrojnë pretendimet ankimore të së paditurës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike lidhur me vendosjen për rehabilitimin fizio terapeutik- klimatik, për shkak se me asnjë provë paditësjë nuk ka provuar që ka qenë në rehabilitim fizioterapeutik –klimatik, prandaj nga kjo bazë Gjykata e Apelit ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për rehabilitim fizioterapeutik- klimatik si të pabazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë sa i përket dhimbjeve fizike, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe frikës janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD-së, këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësjë) t'i përballoj më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para, por të paktën duhet të bëhet kompensimi i ligjshëm i tyre. Me paragrafin 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, frikës si dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të të dëmtuarit ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësjë i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të huaj, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është

i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ndihmë të huaj dhe ushqim të përforcuar, atëherë vërtetohet se të dëmtuarit i takon e drejta në kompensim për këtë formë të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se kamata e gjykuar prej 12% është caktuar gabimisht, pasi që e paditura nuk ka ra në vonesë për trajtimin e dëmit, për shkak se e njëjta trajtimin e dëmit e ka trajtuar pas afatit të parapar ligjor sipas dispozitave të nenit 26 par.1 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, prandaj nisur nga kjo vendimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket kamatës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se e njëjta ka kërkuar që seanca e datës 22.12.2020, të shtyhet dhe se me mbajtjen e kësaj seance të njëjtës i është mohuar e drejta që të deklarohet lidhur me çështjen, kjo nuk qëndron, pasi që me shiqim në shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ekziston ndonjë parashtrësë me anë të së cilës e paditura ka kërkuar që seanca të shtyhet.

Edhe pretendimi ankimor i të paditurës lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës është i pabazuar, pasi që gjykata e shkallës së parë pjesërisht ka aprovuar kërkesën për shpenzimet e procedurës duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.811/2021, me datë 19.06.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v